

## Tre vjet për “Lahutën e Malcisë”

“Lahuta e Malcisë” dhe Gjergj Fishta flasin edhe anglisht. Vepra e poetit të njohur shqiptar është përgatitur dhe përkthyer në Angli dhe SHBA nga albanologu i shquar kanadez, Robert Elsie, e përkthyer nga vetë ai dhe Janice Mathie Heck. I pranishëm, mbrëmjen e djeshme në promovimin e kësaj vepre në anglisht, në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, albanologu dhe përkthyesi Elsie “rrëfeu” pse zgjodhi për të përkthyer Fishtën dhe, ç’ e veçantë, e tërhoqi te “Lahuta e Malcisë”. Arsyeja e mungesës së librave shqip në tregun e huaj, lidhja me gegërishten e Fishtës, etj., shpjegohen nga Elsie në një intervistë për “Metropol”, ku tregon edhe për përgatitjen në anglisht të dy antologjive: të tregimit dhe të poezisë shqiptare.

Ka përkthyer shumë autorë shqiptarë, siç thotë vetë janë afërsisht 50 autorë të ndryshëm, por vetëm pak prej tyre i ka botuar. “Shumica e tyre gjenden në internet (www.albanianliterature.net), nuk janë botuar si libra, pasi është shumë e vështirë të gjendet një shtëpi botuese”, thotë Elsie, duke shtuar se së shpeti do të botojë një antologji të prozës dhe tregimit shqiptar. Libri do të dalë në ShBA në muajin qershor ose në korrik. Përveç kësaj, Elsie po punon edhe për një antologji të poezisë shqiptare dhe për disa vepra të tjera.

**[BG] Në tregun perëndimor vërehet që ka shumë pak autorë dhe libra shqip të përkthyer. Sipas jush, pse ndodh diçka e tillë?**

[RE] Nuk mund të ketë përkthime në treg, nëse nuk ka përkthyes. Kjo është pengesa kryesore. Ka një mungesë përkthyesish. Po të kishte përkthyes shumë, me siguri do të kishte shumë botime. Megjithëse, prap dua të them se në tregun anglishtfolës, të cilin unë e njoh më mirë është shumë e vështirë për të hyrë. Në tregun e librave të letërsisë, më pak se 3 përqind janë përkthime nga gjuhë të huaja. Domethënë, 97 përqind e botimeve janë të shkruara në anglisht dhe ka shumë pak vende dhe në këto 3 përqind vijnë gjithë letërsitë e botës. Kështu që, imagjinoni sa përqind mund të ketë nga kjo, letërsia shqiptare. Por pengesa kryesore është mungesa e përkthyesve.

**[BG] Sipas jush, si mund të zgjidhet ky problem?**

[RE] Kjo zgjidhet me kohë kur ka njerëz, më shumë të huaj që dinë gjuhën shqipe. Por kjo do të zgjidhet ngadalë besoj. Nuk është problem që zgjidhet shumë shpejt.

**[BG] Mos ndoshta, mungesa e përkthyesve të shqipes, ka të bëjë me vështirësitë e kësaj gjuhe?**

[RE] Kjo mund të jetë. Gjuha shqipe nuk është një gjuhë e lehtë për t’u mësuar, por edhe izolimi i Shqipërisë. Shqipëria ka qenë e izoluar për 50 vjet. Asnjëri nuk hynte, asnjëri nuk dilte. Nuk kishte kontakte, përveç disa kontakteve politike të karakterit komunist. Por normalisht, asnjëri nuk mund të hynte dhe ato pak grupe që hynin ruheshin, vëzhgoheshin. Atë pak shqip që dija, në fillim nuk mund ta praktikojta këtu. Po të thoshe në rrugën kryesore: “Mirëdita, si jeni?” njerëzit qeshnin dhe iknin me vrap, sepse e dinin me siguri që do ta kalonin natën me Sigurimin. Isha për herë të parë në Shqipëri në vitin 1978 dhe pata fat që erdha. Isha student në Gjermani dhe pedagogu im kishte lidhje me Akademinë e Shkencave në Shqipëri. Për habinë tonë morëm një ftesë, jo vetëm për profesorin por edhe për të gjithë grupin dhe erdhëm një grup studentësh, afërsisht 20 studentë. Ishtë gjë e madhe.

**[BG] Për herë të parë, “Lahuta e Malcisë” përkthehet në anglisht. Çfarë ju tërhoqi te**

### **kjo vepër dhe sa kohë i keni kushtuar përkthimit të saj?**

[RE] Fillova ta përkthej në vitin 2001 dhe përkthimi zgjati më shumë se 3 vjet. Është përkthim i vështirë; për mua ishte i tillë, prandaj zgjati kaq shumë. Ka shumë gjëra që të tërheqin te kjo vepër. Ka gjëra pafund, por mendoj se çdo njeri do të gjejë te Fishta atë që do. Është një vepër letrare me cilësi të lartë. Ka histori, ka mitologji, ka frymë. Më frymëzoi shumë, megjithëse ka dhe pjesë që më mërzisnin shumë. Ka beteja pafund me gjak, me jataganë, me pushkë, që nuk ishin për mua, por që të tjerët mbase i pëlqejnë. Siç duket, at Fishta kishte qejf për gjak (Qesh).

### **[BG] Për ju është më e lehtë të përktheni nga gegërishtja apo nga toskërishtja?**

[RE] Gegërishtja e Fishtës është një gjuhë shumë e përpunuar, por mjaft e vështirë për mua, sepse kisha mësuar gjuhën letrare. Por me kalimin e kohës u bëra pak malësor edhe vetë. Më të lehtë e kam ende nga toskërishtja, me gjithë përvojën që kam tani me Fishtën. Më duket se Fishta është vepra më e vështirë për t'u përkthyer nga të gjitha. Dhe besoj se nëse arrija të përktheja Fishtën, arrija të përktheja gjithë veprat e tjera. Por e kam më të lehtë gjuha standarde.

### **[BG] Kur keni dëgjuar për herë të parë për “Lahutën e Malcisë”?**

[RE] Kisha dëgjuar për “Lahutën e Malcisë”, por nuk e kisha parë për një kohë të gjatë, sepse në periudhën e komunizmit ajo ishte e ndaluar. Nuk flisnin fare për Fishtën. Ishte një heshtje e plotë. Por kishte një botim të Lahutës në Romë, nëse nuk gabohem të vitit 1958, një libër që nuk gjendej fare në Shqipëri, por që u shpërnda në botën e jashtëme, në emigracion dhe aty e pashë për herë të parë në origjinal. Përveç kësaj kam parë edhe një përkthim në Gjermani të vitit 1955. Kështu që vepra ishte e njohur, por nuk dija në fillim për rëndësinë e këtij libri. Zgjati shumë sa të mësoja pak për Fishtën, por mbase është kjo që, molla e ndaluar të tërheq më tepër dhe Fishta ishte i tillë.

### **[BG] Si është pritur libri i Fishtës në tregun anglishtfolës?**

[RE] Është akoma herët. Libri ka gjashtë muaj që ka dalë në treg. Iu shpërnda fillimisht ekspertëve dhe nuk kam pasur kontakt me shtëpinë botuese, që të di se sa ishte tirazhi, se sa u shit, se kush e bleu. Në përgjithësi letërsia shqiptare ka shumë vështirësi, sepse është e panjohur përveç Ismail Kadarese, që është pjesërisht i njohur. Për Gjergj Fishtën, një autor krejtësisht i panjohur është shumë e vështirë, por mendoj se me kalimin e kohës, me ngadalë libri do të eci. Nuk pres që të gjithë të blejnë “Lahutën e Malcisë” dhe që libri të futet në listën e best-sellerave.

### **Intervistoi: Blerina Goce**

[botuar në *Metropol*, Tiranë, 20 prill 2006, f. 21 / Publish in the newspaper *Metropol*, Tirana, 29 April 2006, p. 21.]